



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione

P-nr.14/2021

Prishtinë, më 22.6.2021, në orën 14.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Albana Bytyçi, Vasfije Krasniqi, Alban Bajrami, Fjolla Ujkani, Ariana Musliu- Shoshi, Eliza Hoxha dhe Marigona Geci.

Munguan: Tinka Kurti, Saranda Bogujevci dhe Milosh Peroviç.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Hilmi Jashari, ish- Avokat i Popullit; Marigona Shabiu-YIHR KS; Besnik Fetahu-GP LVV; Teuta Prekazi-UN IOHCHR; Arbresha Asllani-GP AAK; Lirim Xhimi-KDI; Durim Elshani-GP LVV; Brahim Osmani-vizitor; dhe Celal Ilias-Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Duda Balje, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takim në Komision lidhur me prezantimin e raportit të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut në Kosovë në vitin 2020.
I ftuar: Hilmi Jashari, ekspert i fushës dhe ish-Avokat i Popullit;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

1. Takim në Komision lidhur me prezantimin e raportit të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut në Kosovë në vitin 2020.

I ftuar: Hilmi Jashari, ekspert i fushës dhe ish-Avokat i Popullit

Kryetarja, tha se kemi prezent ish- Avokatin e Popullit, ekspert i fushës, z. Hilmi Jashari dhe Marigona Shabiu, për të bërë prezantimin e raportit të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut në Kosovë, në vitin 2020.

Është rast i mirë që kemi mundësinë të informohemi, si komision, lidhur me këtë raport.

Hilmi Jashari, falënderoi komisionin në emër të organizatave që kanë qenë pjesë e hartimit të këtij raporti dhe tha se paraqet një progres të jashtëzakonshëm në Kosovë, sepse është një praktikë e mirë jo vetëm në Kosovë, por që nuk mund ta gjeni as në rajon dhe është një e mirë që, si komision, të takohemi në Kuvend, është një kulturë e re që mund të krijohet në të ardhmen.

Ai tha se janë 34 organizata të shoqërisë civile, të cilat janë angazhuar në këtë raport dhe ne sot i përfaqësojmë këtu, e kemi një propozim të veçantë që ne sot kishim dashtë me përafuar bashkëpunimin dhe dialogun me shoqërinë civile, sepse ashtu kishim qenë një hap më tutje në avancimin e sistemit të drejtave të njeriut në raport me Republikën e Kosovës.

Ky është raporti i dytë vjetor gjithëpërfshirës për të drejtat e njeriut, nga shoqëria civile, kanë marr pjesë 34 organizatat që kanë kontribuar në hartimin e këtij raporti, është i publikuar në të tri gjuhët dhe është i qasshëm për të gjithë.

Raporti përmban afro 100 rekomandime për institucionet e Republikës së Kosovës, duke filluar nga Kuvendi, Qeveria e degët tjera të ekzekutivit dhe përafërsisht ka mbi 300 referenca, sepse kemi insistuar që raporti të jetë sa me kredibil dhe i besueshëm.

Tha se ky raport është trajtuar në katër pjesë: pjesa e parë përmban të drejtat klasike, civile dhe politike. Në pjesën e dytë të këtij raporti janë përfshirë të drejtat ekonomiko, sociale dhe kulturore, në pjesën e tretë janë përfshirë grupet e cenushme apo të caktuara, duke përfshirë barazinë gjinore, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, të rinjtë dhe komunitetet, ndërsa në pjesën e katërt janë përfshirë çështjet e korrupsionit, drejtësia tranzicionale dhe mjedisi që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në të gjitha të tjerat.

Pjesa e parë, ku janë trajtuar të drejtat civile dhe politike, nëse flasim për çështjen e lirisë dhe sigurisë gjatë periudhës së vitit 2020, ka më tepër se 1000 persona që janë arrestuar me urdhër të prokurorit, janë mbajtur në ndalim 24 orë, pastaj Gjykata Kushtetuese nxori një vendim ku thuhet se ato masa kanë qenë të ndaluara dhe jo në pajtim me Kushtetutën, mandej janë liruar. Mirëpo, deri sot asnjë person nga ky grup nuk ka marrë asnjë formë të kompensimit nga ana e shtetit, sepse këtu konsiderohet se shteti ka bërë shkelje të drejtave të njeriut dhe mendojmë se kjo çështje duhet riadresuar.

Sa i përket gjykimit të drejtë dhe të paanshëm një prej gjetjeve kryesore është se vazhdojnë të kemi probleme të jashtëzakonshme në kuptimin e gjykimit të drejtë, të zvarritjes së procedurës e që është shkelje e të drejtave të njeriut, sepse konventa evropiane dhe vetë kushtetuta garanton gjykimin e drejtë dhe të paanshëm, brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Nga një vlerësim që është bërë nga shoqëria civile, që mesatarja i bien diku 8 vjet për një gjykim të një çështjeje që është tejkalim i të gjitha normave dhe standardeve që Konventa Evropiane që është e zbatueshme në sistemin tonë juridik e ndalon, mirëpo kur kjo ndodh, Konventa dhe Kushtetuta kërkon që këta qytetarë të kompensohen dhe njëra nga rekomandimet që kemi është që të nxirret një ligj që të rikuperohen ose të kompensohen qytetarët, sepse është shkelur një e drejtë e garantuar e tyre.

Lidhur me lirinë e fesë, tha se jeni në dijeni se është mangësia e ligjit, e cila parasheh regjistrimin bashkësive fetare në Kosovë e që është një situatë prej vitit 2009 e që vazhdon të jetë deri më sot.

Ka mendim të Komisionit të Venedikut, sesi duhet tejkaluar kjo situatë dhe cila është zgjidhja ligjore. Ne mendojmë se është moment i përshtatshëm që bashkësive fetare t'u jepet mundësia që në mënyrë të barabartë të regjistrohen si persona juridikë, sepse një pjesë e tyre, siç e dini, nuk arrin për shkak të mangësive ligjore të regjistrohen si persona juridikë dhe pjesën më të madhe të aktivitetit nuk e realizojnë si bashkësitë e tjera fetare që janë të regjistruara. Dhe është e domosdoshme që ky ligj, sa me shpejt të miratohet, dhe nëse ky ligj nuk arrin të miratohet, atëherë duhet munduar për të gjetur alternativa tjera që të mundësohet realizimi i këtij synimi.

Sa i përket të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, si e drejtë më e cenueshme, ka dalë të jetë e drejta e punës, raporti ka trajtuar edhe ndikimin që ka pasur pandemia në sektorin e punës, po mbi të gjitha problemi është me mekanizmat institucionalë që merren me mbikëqyrjen e realizimit të drejtës së punës dhe në radhë të parë bëhet fjalë për Inspektoratin e punës, si mekanizëm kryesor.

Lidhur me të drejtat e arsimit, tha se gjatë kohës së pandemisë, shqetësuese ishte përcjellja e mësimit nga personat me aftësi të kufizuara, pastaj është një numër nxënësish që nuk kanë pasur mundësi të ndjekin mësimin online, sikur nxënësit tjerë dhe kërkohet përkrahje më e madhe nga institucionet dhe të gjithë, për këtë kategori.

Personat me aftësi të kufizuar, problemin kryesor e kanë qasjen në hapësirat publike dhe vazhdimisht përcillet kjo situatë.

Për të drejtat e fëmijëve, tha se është sugjeruar ndryshimi i Ligjit për skemat sociale, ku është një kriter që thotë se familjeve që gëzojnë ndihmë sociale që kanë fëmijë të moshës deri 5 vjeçare, e gëzojnë këtë të drejtë, dhe nëse kanë fëmijë mbi moshën 5 vjeçare, nuk e gëzojnë këtë të drejtë.

Sa i përket punësimit, tha se minimumin që mund ta bëjnë institucionet e vendit është që të bëhet planifikimi i nevojave të tregut dhe që së paku të rinjtë e Kosovës ta kenë informatën e duhur që të mund ta orientojnë veten në profilet që ata dëshirojnë.

Ai bëri një elaborim për të gjitha pjesët e këtij raporti, të cilin tani e kanë edhe anëtarët e komisionit dhe propozoi që 34 organizatat joqeveritare që kanë punuar në këtë raport, t'u jepet mundësia të dëgjohen dhe mënyra më e mirë është që ky komision ta organizojë në sallën e Kuvendit dhe nëse ndodh kjo ka me qenë kjo përvoja e parë në Ballkan, por edhe përtej, sepse ka me qenë një rast unik që shoqëria civile, së bashku me Kuvendin e Kosovës, do të jenë në gjendje të bashkëveprojnë për interesa të qytetarëve.

Kryetarja pyeti: a është paraqitur gjendjen e pakicave në Kosovë, sepse është e rëndësishme të pasqyrohet drejt kjo gjendje?

Hilmi Jashari, tha se nga mekanizmat ndërkombëtarë, që Kosova është pjesë e tyre, Kosova vlerësohet për respektimin e pakicave kombëtare. Kosova është pjesë e Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare të Këshilli të Evropës dhe raporton në mënyrë të rregullt. raporti i fundit që është bërë nga vizita që ka pasur ky komunitet i kësaj konvente në Kosovë, është diku në vitin 2017 dhe raporti është publik.

Vlerësimet e këtij raporti janë krahasuar me inspektimin që Këshilli i Evropës ka bërë në Serb. Situata është dukshëm më e dallueshme dhe nuk kemi nevojë ndoshta të nxjerrim vlerësim vetjak, sepse mjafton t'i referohesh Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare edhe për Serbinë, edhe për Kosovën, që është njëra prej instrumenteve kryesore që vlerësohet në nivelin e Këshillit të Evropës.

Kosova është në pozitë shumë më të avancuar. Në Kushtetutën e vendit ka vende të rezervuara për pakicat kombëtare, që nuk mund të gjesh në kushtetutat e vendeve të tjera.

Gjithashtu, Kushtetuta e Kosovës përmban një gjendje unike, lidhur me ligjet e interesit vital që afekton kryesisht te pakicat kombëtare dhe ky standard është bukur i avancuar, krahasuar me vendet e rajonit dhe gjithashtu Kushtetuta e Kosovës përmban një kapitull të veçantë për komunitetet. Po ashtu, tha se të drejta të avancuara, komunitetet gëzojnë edhe në nivelin lokal, ku pakicat përbejnë më shumë se 10 % të popullsisë së asaj komune.

Marigona Shabiu, tha se në vitin 2019, e kemi pasur publikimin e raportit të parë. Ky është publikimi i raportit të dytë dhe është një praktikë që ne si shoqëri civile po synojmë që ta mbajmë në baza vjetore.

Ajo tha se e vlerësojmë shumë dialogun të cilin synojmë ta zhvillojmë edhe më tej me institucionet, në këtë rast me Kuvendin dhe më konkretisht me Komisionin parlamentar për të Drejtat e Njeriut, besojmë që roli i juaj është shumë pozitiv dhe sigurisht është shumë i fuqishëm në shtyrjen përpara të rekomandimeve që ne i kemi ofruar në këtë raport.

Ajo shtoi se në këtë raport janë trajtuar edhe të drejtat e komunitetit LGBTI, që konsiderohet një komunitet i cenueshëm në shoqërinë tonë. Organizatat që merren konkretisht me këtë komunitet kanë punuar në këtë raport, i kanë shpërfaqur të gjitha sfidat dhe rekomandimet, të cilat u drejtohen institucioneve relevante.

Fjolla Ujkani, pyeti: kush është faktori kryesor që në Kosovë ka pasur një progres, lidhur me të drejtat e njeriut në Kosovë gjatë vitit 2020?

Hilmi Jashari, tha se progres e konsideron një raport të tillë që për herë të parë, me rekomandime, i adresohet vendit tonë dhe është një mobilizim i shoqërisë civile në tersi. Pra, besoj se ky është progres në vete, por jo sistemi i të drejtave të njeriut, nuk mund të themi, sepse raporti ka gjetur shumë mangësi në sistem.

Alban Bajrami, tha se disa pika që janë ngritur në këtë raport janë paraparë edhe në programin qeverisës. Ideja e dëgjimit publik është një ide shumë e mirë dhe shoqëria civile në Kosovë duhet ta ketë të qartë se bashkëpunimi është më së i mirëpritur, për shkak se maksimalizimi i rezultateve është qëllimi.

Eliza Hoxha, tha se ndihet mirë që aktorët e shoqërisë civile kanë mbërri të bëhen, për ta pasur njëfarë pasqyre të krejt sfidave që i kemi si shoqëri dhe për t'i adresuar ato nëpër institucione, ku kanë mundësi me u riparuar të gjeturat që janë listuar në raport.

Tha se me siguri jeni në dijeni për raportimet lidhur dhe me vendosjen e manastirit të Deçanit, ku hyn në monumentet me rrezikshmëri të lartë. E shoh që është i përfshirë në raportin tuaj dhe i sqaruar. Pse ka mundur të hyjë në atë listë, ndoshta pikërisht për shkak të zhurmës që është bërë për rrugën që duhet të kalojë andej?

Tha se në këtë rast rruga pengohet dhe kjo mund të jetë ndoshta ideja që është vendosur si i cenueshëm dhe në rrezik, përderisa ne kemi rastet e hidrocentralit të "GEL KOSIT", i cili në fakt dhe objektin e tretë e ka diku 500 metra ne largësi me manastirin dhe ne fakt është ne zone të mbrojtur, dhe ambiguiteti i veprimeve të caktuara në raport me një zonë të mbrojtur është problematik, sepse ose kemi të bëjmë me zonë të mbrojtur, ku nuk ka mundësi të bëhen ndërhyrje të tilla e as rrugë. Ndoshta, meqë është rasti për objektet e religjionit ortodoks, të cilat mbrohen me pakon e Ahtisaarit, specifikisht, ose duhet të jemi të hapur që në aspektin e infrastrukturës kapitale për interesin e përgjithshëm publik në nivel nacional duhet të vlejë e njëjta rregull për të gjithë, barabartë, dhe kjo është një shkelje, sepse t'i lidhësh fshatrat që janë sipër me qytetin e Deçanit është domosdoshmëri e nëse duhet t'i biem rreth e rrotull, atëherë duhet ta zhvendosim edhe hidrocentralin, sepse edhe uji, edhe rryma janë domosdoshmëri, dhe

kur jemi këtu, nganjëherë luhet edhe me kartat etnike dhe të trashëgimisë kulturore për disa çështje të caktuara. Duhet të kemi debat të sinqertë, me të gjitha komunitetet, nëse flasim për diçka që duhet të jetë parimore dhe të kemi qasje të njëjtë, pavarësisht se kujt i takon si besim ose si zonë trashëgimore, një zonë e caktuar.

Mendoj se manastiri i Deçanit, hiç nuk është në aspektin e rrezikshmërisë i cenueshëm, sepse e kam vizituar disa herë, por narrativet dhe zhurmat që janë bërë rreth rrugës, e qesin në lajthitje ndoshta edhe një komunitet jashtë Kosovës, pa qenë këtu për ta bërë një vlerësim të tillë.

Kryetarja, tha se në komuniteteve ju kemi dhënë të drejta bazike shumë të mëdha, që nuk ka ndodhur në asnjë vend në rajon. Këtë e kam thënë shumë haptas edhe në Bosnjë, por nuk kemi bërë shumë marketing për këtë e as organizatat joqeveritare të komuniteteve e që në numër janë shumë dhe janë shumë aktive. Ajo tha se komuniteti serb në Kosovë është i super privilegjuar dhe prapë kanë ankesa më së shumti.

Hilmi Jashari, tha se Kosova nuk ka Ligj për persona të kthyer dhe kjo është problem. Bosnja e ka një ligj të tillë dhe nëse i shihni listat e statistikave që prodhon Zyra e Komisionarit të Lartë për Refugjatë, statistikat që prodhohen nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe statistikat që prodhohen nga Ministria për Kthim, janë tri lloj grupime statistikore që ndryshojnë njëra me tjetrën.

Ligji në Bosnjë e ka rregulluar shumë mirë dhe thotë se një person mund të konsiderohet refugjat në periudhën maksimale prej 6 muajsh, sepse në momentin kur ai riintegrohet në shoqëri, nuk mund të konsiderohet akoma refugjat.

U përmend interesi publik, Konventa Evropiane është e zbatueshme neni 1 Protokolli 1 i kësaj konvente që flet për të drejtën pronësore, thotë në mënyrë shumë eksplicite se, nëse është interesi nacional nuk ka asnjë pengesë që do të duhej t'i vihej qoftë edhe nëse është e rregulluar me ligj.

Marigona Geci, falënderoi mysafirët për prezantimin në mënyrë të përmbledhur të të gjeturave të këtij raporti të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut dhe tha se e mbështet takimin me këto 34 organizata që kanë qenë pjesë e hartimit të këtij raporti.

Kryetarja falënderoi për prezencën dhe tha se sot do të fillojmë procedurën për ta realizuar një takim të komisionit me këto organizata të shoqërisë civile, sepse më sa pushë, komisioni ishte për, dhe do të bëjmë kërkesën në Kryesi të Kuvendit, për ta shfrytëzuar sallën e Kuvendit. Po ashtu, tha se personalisht do të bisedojë me Kryetarin e Kuvendit, lidhur me shfrytëzimin e sallës së Kuvendit, për këtë takim.

3. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk është ngritur asnjë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetare e komisionit,

Duda BALJE